

VENDIM
Nr.664, datë 26.10.2005

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2005, MIRATUAR PËR AKADEMINË E SHKENCAVE, PËR FINANCIMIN E KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE SHKENCORE “GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU DHE EUROPA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 7 e 10 të ligjit nr.9339, datë 23.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Akademisë së Shkencave, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, t’i shtohet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, për financimin e konferencës ndërkombëtare shkencore “Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Europa”, që do të zhvillohet në Tiranë, më datat 2-3 dhjetor 2005, në kuadër të përkujtimit të 600-vjetorit të lindjes së heroit kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe kryetari i Akademisë së Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha